



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 016-40598

Më datë 17.08.2026

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", e në mbështetje të nenit 31 të Udhëzimit administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për administratë të hapur në Komuna, e konform nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e grupit punues

1. Formohet grupi punues për organizimin dhe mbajtjen e dëgjimeve buxhetore për planifikimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2027, në këtë përbërje:

- | | | | |
|-----|-------------------|-------|----------|
| 1.1 | Amir HOXHA | ----- | kryesues |
| 1.2 | Erza RAMADANI | ----- | anëtare |
| 1.3 | Remzi BAJSELMANI | ----- | anëtar |
| 1.4 | Kymete BAJRAKTARI | ----- | anëtare |
| 1.5 | Donjeta KABASHI | ----- | anëtare |
| 1.6 | Armend KRASNIQI | ----- | anëtar |
| 1.7 | Kujtime ALIAJ | ----- | anëtare |
| 1.8 | Florinda ISUFAJ | ----- | anëtare |

2. Detyrë e grupi punues është që të organizon dhe të mbajë takime me qytetaret, grupet e interesit, OJQ, bizneset, etj të Komunës së Suharekës, me qëllim të prezentimit të planifikimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për vitin 2027 dhe marrja e kërkesave nga të lartpërmendurit, evidentimi i tyre si dhe në përfundim të bëhet inkorporimi i kërkesave në planifikimin e projekt-buxhetin e vitit 2027 .

3. Zyrtaret e cekur në pikën 1.7 dhe 1.8 të pikës 1, të këtij vendimi për punën jashtë orarit të punës do të kompozohet konform nenit 7, lidhur me nenin 8, të Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës, sipas Ligjit dhe akteve tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës që e rregullojnë këtë çështje.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Të njoftohen;
Anëtarët e grupit punues
Evidenca



Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ